



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

UDHËZUES PËR APLIKANTËT

PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL 2022/23
(PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE)

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Programi për Zhvillim Rajonal
**THIRRJE PËR PROJEKT-IDE
PËR INVESTIME KAPITALE**
me fokus në:

- TURIZËM NATYROR
- TURIZËM KULTUROR
- TURIZËM SPORTIV
- TURIZËM SHËNDËTËSOR
- INFRASTRUKTURË PUBLIKE PËRCJELLËSE

* Thirrja është e hapur për 38 komunat
Për më shumë detaje, referoni tek veprimi vijim:
<https://mzhr-ks.gov.net/faqe/faqe/38-1-26>

Sesione të informuese dhe punëtoritë para-përgatitore do të organizohen nga MZHR në partneritet me Programin për Zhvillim Gjithëpërfshirës të zbatuar nga UN-Habitat Kosova dhe financuar nga Sverige

PRISHTINË

Gusht, 2022

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
OBJEKTIVAT E PROGRAMIT.....	3
REZULTATET SPECIFIKE	4
LLOJET E AKTIVITETEVE.....	5
VLERA E PROJEKTEVE ME TË CILAT APLIKOJNË KOMUNAT	5
KRITERET E PRANUESHMËRISË	7
SI TË APLIKONI.....	8
VLERËSIMI I PROJEKTIT	9
KUSHTET E PRANUESHME.....	9
ROLI I AGJENSIONEVE PËR ZHVILLIM RAJONAL	10
PROCEDURAT E IMPLEMENTIMIT	10
PROCEDURAT E PROKURIMIT	10
MONITORIMI DHE RAPORTIMI	10
PAGESAT E VAZHDUESHME PËR OPERATORËT EKONOMIK TË KONTRAKTUAR.....	11

HYRJE

Zhvillimi rajonal është një term i gjerë, por mund të konsiderohet si një përpjekje e përgjithshme për të përmirësuar mirëqenien dhe standardet e jetesës në të gjitha llojet e rajoneve, nga qytetet në zonat rurale, dhe për të përmirësuar kontributin në performancën kombëtare dhe në një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme¹.

Kosova ka pesë rajone zhvillimore ekonomike: qendër, lindje, perëndim, jug dhe veri. Këto rajone kanë veçoritë e tyre unike, por në të njëjtën kohë karakterizohen nga pabarazitë substanciale dhe nivelet e ndryshme të zhvillimit socio-ekonomik.

Me qëllim të zbutjes të këtyre pabarazive dhe për nxitur një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm social dhe ekonomik i cili mbështetet në potencialet e rajoneve dhe duke ruajtur karakteristikat e tyre natyrore dhe kulturore, Ministria për Zhvillim Rajonal ka dizajnuar Programin për Zhvillim Rajonal.

Ky program mbështetet në vizionin dhe objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Kosovës² dhe dokumentet tjera strategjike në nivel vendi, do të zbatohet nga Ministria për Zhvillim Rajonal dhe ka për synim përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve përmes ofrimit të kushteve më të mira shoqërore dhe ekonomike.

Programi, do të zbatohet nga Ministria për Zhvillim Rajonal e cila synon të rrisë kohezionin rajonal, të zvogëlojë pabarazitë në shfrytëzimin e burimeve, të rrisë produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore, duke ofruar, nga ana tjetër, mbështetje të drejtpërdrejtë financiare në formën e granteve për autoritetet vendore (komunat), meqenëse këto të fundit janë aktorët aktivë në terren. Shuma e këtij programi për vitin 2023 do të jetë rreth **2,000,000.00 EURO**.

Vlen të ceket se MZHR nga kjo shumë ka të kontraktuar 4 Projekte dy vjeçare me 4 Komuna, dhe shuma e përgjithshme e këtyre Projekteve për virin 2023 kap vlerën prej 800,000.00 EURO, rrjedhimisht shuma e mbetur për Projekt Propozimet e reja është **1,200,000.00 EURO**.

MZHR ka bërë kërkesë për rritje të buxhetit për këtë kategori, nëse Qeveria e Republikës së Kosovës e vleron kërkesën e MZHR-së për rritje të buxhetit për vitin 2023 atëherë projektet që mbeten në listën Rezervë/pritje do të mbështeten deri në shpenzim të buxhetit.

Sesionet informuese për këtë thirrje organizohen nga MZHR në partneritet me UN-Habitat-in në Kosovë përmes Programit për Zhvillim Gjithpërfshirës dhe financuar nga Qeveria e Suedisë.

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Objektivat kryesore:

- Mbështetja e projekteve të dizajnuara përmes qasjeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse dhe që janë në harmoni me objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal dhe strategjitë tjera relevante lokale.
- Rritja e potencialit ekonomik, turistik dhe ndjeshmërisë mjedisore në të gjitha komunat, respektivisht rajonet e Kosovës përmes projekteve që ndërlidhin aspektet turistike, sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore.

Objektivi specifik

- Përkrahja e komunave me grante për identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e projekt-ideve që bazohen në karakteristikat dhe potencialet e vendit/rajonit, dhe që ndërlidhen me zhvillimin e potencialeve të turizmit natyror, kulturor, sportiv dhe shëndetësor, përmes ndërhyrjeve konkrete dhe vizive në zonat urbane dhe rurale.

Disa shembuj (për inspirim) janë paraqitur më poshtë, por mund të eksperimentohet edhe me projekt-ide tjera atraktive që bijnë në kuadër të kësaj fushe.

Natyrore: parqe të aventurave, shtigje për ecje, shtigje natyrore, shtigje për alpinizëm, ballkone panoramike, ura (druri, guri, etj.)

Kulturore: restaurimi/Rehabilitim i objekteve të trashëgimisë kulturore; rehabilitim i lagjeve të caktuara, rindërtimi i qendrave historike të qyteti, ndërtim i muzeve specifike për rajonin (që ndërthurin modernen me elemente specifike të rajonit),

Sportiv: fusha sportive, objekte spotive, platforma fluturimi (me parashuta, etj.)

Shëndetësor: ndërtimi i qendrave rehabilituese (për personat me varësi të ndryshme, ose qendra tjera me karakter të ngjashëm).

Infrastrukturë përcjellëse: shtigje, ndriqim, stacione, vendpritje etj.

REZULTATET SPECIFIKE

Krijimi i këtij Programi do t'i mundësoj komunave për të zhvilluar më tej rolin e tyre udhëheqës në përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik përmes projekteve që kontribuojnë në një apo më shumë prioritete të listuara në Strategjinë e tyre për Zhvillimit Rajonal/lokal. Më konkretisht, rezultatet e pritshme janë si në vijim:

Rezultatet e pritshme afatshkurtëra:

- Kapacitete të fuqizuara komunale për identifikimin, zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e projekteve kapitale
- Projekte të identifikuara dhe zhvilluara bashkarisht me komunitetin dhe palët relevante të interesit (përfshirë OJQ-të, etj.)
- Projektet të bazuara në karakteristikat dhe potencialet vendore, por që kanë ndikim pozitiv socio-ekonomik në rajone të caktuara

- Projektet që rrisin kohezionin social por edhe promovojnë dhe mbrojnë asetet natyrore dhe kulturore të rajoneve
- Projekte të identifikuar dhe zhvilluara nga dy ose më shumë komuna përmes bashkë-financimit (preferohen dhe inkurajohen)
- Pronësi më e madhe mbi projektet e realizuara nga autoritetet publike, komuniteti, shoqëria civile, palët e interesit, etj.
- Gadishmëri politike dhe teknike e shprehur përmes planifikimeve buxhetore adekuate si dhe proceseve të hapura dhe transparente

Rezultatet e pritshme afatgjate:

- Autoritet publike (komunale) të përgaditura në menaxhimin e suksesshëm të gjithë ciklit të projekteve të investimeve kapitale
- Shkallë më e lartë e gjithëpërfshirjes dhe transparencës gjatë identifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të ciklit të projekteve
- Përmirësim i kualitetit të jetesës së qytetarëve në zonat, rajonet e caktuara
- Më pak pabarazi në mes të rajoneve në Kosovë

LLOJET E AKTIVITETEVE

Projektet do të kategorizohen si investime kapitale, të ndërlidhura me objektivin e përgjithshëm të Programit.

VLERA E PROJEKTEVE ME TË CILAT APLIKOJNË KOMUNAT

Shuma e përgjithshme e mundshme që ofrohet përmes kësaj Thirrjeje për Aplikime është **2.000,000.00 EURO**. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos i akordojë të gjitha fondet në dispozicion.

Vlera e projekteve:

Kategoria e parë:

I dedikohet projekteve të infrastrukturës publike për zhvillim socio-ekonomik rajonal dhe projekteve që ndërlidhen me zonat ekonomike sipas kërkesave të komunave në kuadër të thirrjes për propozime të lansuar nga MZHR.

Nëse në kuadër të kësaj thirrje aplikon **vetëm një komunë** si e vetme, vlera e kërkuar për projekt nga MZHR duhet të jetë brenda vlerave të mëposhtme (minimale dhe maksimale).

<u>Shuma minimale e projektit</u>	<u>Shuma maksimale e projektit</u>
50,000.00€	250,000.00€

Në rastet kur projekt propozimi ka premisa që përmbushin kriteret dhe përputhet me mandatin e MZHR-së, atëherë projekt propozimi mund të tejkaloj këto vlera por që financimi dhe zbatimi i projektit do të vazhdoj për më shumë se një (1) vit.

Kategoria e dytë:

I dedikohet projekteve të infrastrukturës publike për zhvillim socio-ekonomik rajonal dhe projekteve që ndërlidhen me zonat ekonomike sipas kërkesave të komunave në kuadër të thirrjes për propozime të lansuar nga MZHR

Nëse në kuadër të kësaj thirrje aplikojnë **dy apo më shumë komuna**, vlera e kërkuar për projekt nga MZHR duhet të jetë brenda vlerave të mëposhtme (minimale dhe maksimale), pa TVSH:

<u>Shuma minimale e projektit</u>	<u>Shuma maksimale e projektit</u>
100,000.00€	300,000.00€

Në rastet kur projekt propozimi ka premisa që përmbushin kriteret dhe përputhet me mandatin e MZHR-së, atëherë projekt propozimi mund të tejkaloj këto vlera por që financimi dhe zbatimi i projektit do të vazhdoj për më shumë se një (1) vit.

Kategoria e tretë:

I dedikohet kërkesave të komunave që gjatë vitit 2022 nuk kanë arritur të zbatojnë në tërësi projektet për të cilat kanë Memorandum Mirëkuptimi me MZHR-në.

<u>Shuma minimale e projektit</u>	<u>Shuma maksimale e projektit</u>
20,000.00€	100,000.00€

Të gjitha shpenzimet e propozuara të buxhetit duhet të jenë të pranueshme sipas LMFPP (Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë) të Kosovës dhe Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës (LPPK) që duhet të zbatohet gjatë gjithë kohës.

Projektet Softuerike zhvillohen drejtëpërdrejt nga MZHR.

KRITERET E PRANUESHMËRISË

Kriteret për aplikues:

Secila nga 38 komunat e Kosovës mundë të aplikojnë për Programin për zhvillim rajonal. Aplikantët tjerë potencial si Këshillat e komuniteteve, OJQ, Asociacionet e ndryshme etj, duhet t'i adresojnë kërkesat e tyre përmes komunave.

Kriteret administrative:

Komunat aplikuese duhet të zhvillojnë idenë e tyre në formë të projektit ideor që përmban:

- pjesën narrative e cila zhvillohet duke e mbushur njërin nga format aplikuese (Shtojca 1 apo 2);
- pjesën grafike në formë të një dizajni paraprak sipas të projektit të propozuar. Dizajni mundë të jetë në formë skice apo vizatimi me anë të cilit kuptohet ideja e projektit gjatë vlerësimit të tij nga MZHR-ja.
- Pjesën e kostos së përafërt për aktivitetet/ komponentat kryesor të projektit.

Kriteret e projektit:

1. Komuna duhet të propozoj projektin që është në pajtueshmëri me objektivin e përgjithshëm të Programin për zhvillim rajonal; si dhe në pajtueshmëri me Strategjitë e Zhvillimit Rajonal/ Lokal në raste ku ato janë hartuar;
2. Përtej ndikimit socio-ekonomik, projekti duhet të kontribuojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit natyror ose të mundësojë lehtësimin e riskut të fatkeqësive natyrore dhe pasojave të tyre. Për projekte me ndikim të theksuar ekonomik, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) do të aplikohet sipas legjislacionit në fuqi në rast të përzgjedhjes së projekti për bashkëfinancim.
3. Komuna duhet të sigurojë se identifikimi dhe përzgjedhja e projektit është bërë përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës duke përdorur së paku një metodologji (takime publike fizike apo online, punëtori, hulumtime, pyetësorë apo ndonjë metodë tjetër të aplikueshme). Dëshmitë mbi këtë proces (raporte, foto, lista të pjesëmarrësve) i bashkëngjiten aplikacionit.
4. Projektet duhet të jenë projekte të reja dhe jo vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër (Përjashtimisht në rastet kur projekti bartet nga viti paraprak i financuar nga MZHR dhe për të cilin komuna ofron arsyeshmëri të mjaftueshme);
5. Projekti duhet të përmbajë një plan menaxhimi realist dhe të implementueshëm.
6. Inkurajohen Komunat për aplikim me projekte të përbashkëta (dy e më shumë Komuna).
7. Minimumi i bashkëfinancimit nga Komunat për Projekte është 20% e vlerës së Kontratës së nënshkruar nga Komunat me OE (operatorin Ekonomik).
8. MZHR inkurajon dhe mirëpret gjetjen e Donatorëve nga Komunat për bashkfinancim të Projekt Propozimeve të tyre në rastet kurë shumat e projekteve tejkalojnë mundësitë buxhetore të MZHR-së dhe Komunës (Marrëveshje tripalëshe), sikur që Komunat janë

të lira në gjetjen e Donatorëve për mbulimin e shumës minimale (prej 20%) që Komuna merr si obligim për bashkëfinancim.

9. Të jetë realist dhe i zbatueshëm brenda Programit për zhvillim rajonal, respektivisht:
- projekti të përfundojë brenda vitit 2023 (përfundimisht projekteve që me MM parshihen si projekte që financimi dhe implementimi i tyre zgjatë më shumë se një vit). Kjo dëshkohet me planin dinamik i cili i bashkëngjitet aplikacionit; dhe
 - vendi i projektit të jetë pronë e komunës apo pronë tjetër publike ku komuna ka të drejtë formale për realizimin e projektit në atë lokacion dhe të gjitha asetet dhe të drejtat ti takojnë komunës kur projekti të jetë operacional. Edhe në këtë rast dëshmia mbi pronën apo marrëveshja mbi qasjen formale duhet ti bashkëngjitet aplikacionit.

SI TË APLIKONI

Ky udhëzues dhe format për aplikim në kopje fizike janë në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, por të njëjtat publikohen në uebfaqen e MZHR-së.

Pyetjet në formularin e aplikimit duhet të plotësohen sa më shumë dhe sa më qartë që të jetë e mundur. Të gjitha pyetjet në formular janë të rëndësishme për aplikantët mirëpo kërkohet vëmendje e veçantë më sa vijon:

- Qëllimi i përgjithshëm dhe objektivat e projektit
- Pse është i nevojshëm projekti
- Cilat janë rezultatet e drejtpërdrejta të projektit
- A mundet projekti të përfundojë me kohë
- Qëndrueshmëria e projektit
- Aspekti mjedisor

Nëse një komunë ka miratimin ose bashkëpunimin për projektet e tyre me ministrinë përkatëse, të dhënat duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Një bashkëpunim i tillë është shpesh i nevojshëm për projektet lidhur me turizmin, bujqësinë, mjedisin dhe infrastrukturën tjetër komunale.

Formulari i aplikimit është në shtojcën (1) dhe duhet të plotësohet në mënyrë elektronike. Ai duhet të dorëzohet në MZHR deri më datë **02.09.2022** (Përfundimisht kërkesave individuale të komunave të cilat mund të dorëzohen gjatë gjithë vitit 2023), në formën e printuar të kërkesës origjinale, të nënshkruar nga kryetari ose të skenuar dhe të dërguar përmes postës elektronike në email-in zyrtar të MZHR-së Shkrimorja.MZHR@rks-gov.net në rastet kur kemi aplikacione në partneritet me Komunitat tjera duhet plotësohet edhe Deklarata e Partneritetit siç është e përcaktuar shtojcën (2);

Për rastet e projekteve ku Komunitat kanë MM me MZHR-në për vitin 2022 dhe të njëjtat nuk përfundojnë në v.2022 (por jo për ato që nuk ka pasur s'paku një pagesë gjatë vitit 2022) komunitat që kanë interesim ti vazhdojnë ato projekte me MZHR duhet të dorëzojnë kërkesën sipas/nga Kategoria e tretë me arsyeshmëri të mjaftueshme në mënyrë që MZHR ta shqyrtojë për financim.

VLERËSIMI I PROJEKTIT

Komisioni i vlerësimit do të jetë nga stafi i MZHR-së. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimit mund të kërkoj nga ministritë/komunat përkatëse informata shtesë për një projekt propozim specifik.

Kualifikueshmëria e projekteve

Vetëm ato projekt-propozime që arrijnë një rezultat minimal prej 50% të pikëve do të kualifikohen. Nëse Programi vihet në dispozicion (p.sh nëpërmjet projekteve të miratuara mirëpo që kanë dështuar të pajtohen me Marrëveshjen e Mirëkuptimit), atëherë komisioni i vlerësimit do të rekomandon projektin e radhës për miratim nga lista rezervë.

Projektet e bartura

Projektet e pa përfunduara / të bartura vazhdojnë vetëm me Aneks marrëveshje të Mirëkuptimit pas rekomandimit të komisionit vlerësues.

Projektet e pa përfunduara të vitit 2022 vazhdojnë vetëm nëse Komunitat përkatëse parashtrajnë kërkesa, kërkesa këto të cilat do të trajtohen nga Komisioni vlersues dhe vetëm nëse Komisioni vlersues rekomandon vazhdimin e Projektit atëher kjo bëhet me Aneks marrëveshje të Mirëkuptimit.

Aplikacionet e suksesshme/ pa-suksesshme

Komunitat me aplikime të suksesshme, do të jenë të informuara se projektet e tyre janë miratuar dhe do të ju ofrohen Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MM) të cilat do të hartohen nga MZHR-ja. Pasi që të nënshkruhet MM në mes të palëve nënshkruese, MZHR apo komuna varësisht nga MM do të filloj me procedurat për implementimin e projekteve. Projektet që nuk e kalojnë pragun e pikëve prej 50% MZHR nuk do ti financon.

KUSHTET E PRANUESHME

Ky fond do të jetë i hapur për aplikime nga komunitat. Çdo komunë mund të paraqes aplikacionet sipas kategorive të përcaktuara. Aplikacionet duhet të ndjekin kriteret e përcaktuara në paketën e aplikimit dhe duhet të jenë brenda kompetencave vetanake të komunitave siç përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë.

Kostot e pranueshme

Kosto e pranueshëm e projektit duhet të përfshijnë kosto esenciale për sigurimin e realizimit të suksesshëm të projektit.

Kostot e papranueshme

Të gjitha shpenzimet për zhvillimin dhe menaxhimin e projektit sa i përket burimeve njerëzore nuk do të kompensohen për realizimin e projektit.

ROLI I AGJENSIONEVE PËR ZHVILLIM RAJONAL

Komunat mund të ftojnë AZHR-të ku ato bëjnë pjesë, për të ndihmuar zhvillimin dhe përgatitjen e projekteve të pranueshme në bazë të strategjive lokale dhe rajonale për zhvillim ekonomik. AZHR-të mund të ndihmojnë komunat në hartimin e projekt propozimeve.

PROCEDURAT E IMPLEMENTIMIT

Zhvillimi dhe miratimi i marrëveshje të mirëkuptimit (MM). Komunat të cilat i dorëzojnë aplikacionet e suksesshme, do të informohen nga MZHR-ja sa më shpejt të jetë e mundur pas përfundimit të procesit të vlerësimit. MM do të përgatiten nga MZHR-ja dhe do të diskutohen me komunat. Pasi të jenë pajtuar të dy palët mund të nënshkruhen MM.

PROCEDURAT E PROKURIMIT

- Bartëse e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e Operatorit është MZHR përveq nëse ndryshe përcaktohet me marrëveshje të mirëkuptimit.
- Në rastet kur komunat do të zhvillojnë procedurat e prokurimit MZHR merrë pjesë me 1 (një) anëtar në hapje të ofertave, në proces të vlerësimit, në trajtim të kërkesave për rishqyrtim dhe në ri-vlerësim nëse ka një vendim për rishqyrtim.
- Procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në harmoni të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë (LPP).
- Në rastet kur komunat zhvillojnë procedurat e prokurimit dhe tenderimit me sukses dhe kemi nënshkrim të kontratës në mes Komunës me OE, komunat janë të obliguara ta njoftojnë MZHR-në për kontratën dhe të deklarojnë shumën e mbetur nga zotimi i MZHR-së (në rastet kur shuma e kontratës është më e vogël se sa shuma e zotimit të MZHR-së).

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

- MZHR-ja do të monitoroj projektet në secilen fazë të punimve.
- Një zyrtar nga MZHR caktohet përgjegjës për bashkëpunim në mes të Menaxherit dhe Organit mbikqyrës të caktuar me vendim nga Kryetari i Komunës përfituese pas nënshkrimit të Kontratës në mes Komunës përfituese dhe OE,
- Një zyrtar i MZHR-së do të monitoroj projektin gjatë gjithë fazave të implementimit, gjithsesi MZHR mund të angazhojë kompani mbikëqyrëse për të monitoruar pjesën e financimit të projektit.
- Komunat obligohen të raportojnë mbi progresin e projektit për MZHR-në si dhe një raport final në fund të projektit.
- Komunat pas dorzimit të raportit narativ të implementimit të Projektit duhet fillojnë procedurat e pranimit teknik.
- Pas pranimit teknik Komunat kompletojnë dokumentacionin dhe të njëjtin e përcjellin tek zyrtari përgjegjës i MZHR-së për evidentim dhe regjistrim të pasurisë.
- Zyrtari përgjegjës i MZHR-së për evidentimin dhe regjistrimin e pasurisë me rastin e kompletimit të dokumentacionit përmes procedurave në afatin sa më optimal të njëjtin Projekt e bartë në pasuri të Komunës përfituese.

PAGESAT E VAZHDUESHME PËR OPERATORËT EKONOMIK TË KONTRAKTUAR

Operatorët ekonomik do të përgatitin dhe paraqesin faturat e tyre në MZHR/Komuna, me të cilët ata kanë kontratë. Ata duhet të dorzojnë kërkesën për pagesë dhe pasi të vërtetohet se të gjitha procedurat e rregullta janë përfillur, do t'i bëhet pagesën bazuar ne Ligjin e menaxhimit te financave publike në Kosovë. MZHR/Kompania mbikëqyrëse do ti verifikon të gjitha pozicionet - punimet e kryera në teren para se të bëhet pagesa. Fatura përfundimtare duhet të dorëzohet me raportin përfundimtar, me së largu më **16.12.2023**.

Programi për Zhvillim Rajonal 2022/2023

Orari inidkativ

DATA/AFATET DHE MUAJI	AKTIVITETI
15 Gusht 2022	Lansimi i Thirrjes së MZHR-së për Zhvillim Ekonomik Rajonal
23 - 24 Gusht 2022	Sesionet Informuese për të gjitha Rajoinet Zhvillimore
02 Shtator 2022	Afati i fundit për dorëzimin e Projekteve nga Komunat në MZHR (Përgjashtimisht kërkesave nga kategoritë dy dhe tre që pranohen vazhdimisht gjatë vitit 2023)
05 - 16 Shtator 2022	MZHR-ja kryen vlerësimin e projekteve.
19 – 23 shtator 2022	MZHR-ja merr vendim për aplikacionet e suksesshme dhe fillon me përgatitjen e Marrëveshjet të Mirëkuptimit
26 Shtator 2022	Komunave përmes postës elektronike ju dërgohet drafti final i MM
27 – 29 Shtator 2022	Marrëveshjet e Mirëkuptimit nënshkruhen nga palët e përcaktuara në MM
Janar/Shkurt 2023	Përgaditja e PIP dhe Miratimi i projekteve në Qeveri Zotimi i fondeve sipas projekteve
Shkurt/Mars 2023	Përgatitja e dokumentacionit dhe shpallja e tenderit Fillojnë procedurat e prokurimit sipas MM
Mars/Prill/Maj 2023	Vlerësimi i tenderëve dhe përgatitja e kontratave, Fillimi i punimeve,
Maj/Dhjetor 2023	MZHR-ja monitoron dhe kontrollon implementimin e projektit. Raportet e progresit nga komunat ose MZHR përcaktohen me MM. MZHR dhe komunat në mënyrë sistematike prezantojnë në platformat sociale (Facebook, Instagram, Tëitter, etj.) progresin gjatë zbatimit të projekteve. Postimet (tekst i shkurtër dhe disa foto) duhet të përmbajnë logot e MZHR-së si dhe komunave përkatëse.
Qershor/Dhjetor 2022	Pranimi i lendeve për pagesë nga komunat. Afati i fundit pranimin e lëndëve për pagesë nga komunat 16.12.2023
Janar 2024	Raporti final